



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 99-Shtator 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga salla e sportive në Carrallukë



Përmbajtja

Filloj viti i ri shkollor 2011-2012.....	1
U përruar salla e sporteve në Carrallukë	3
Për dy muaj 231 intervenime në shuarjen e zjarrit.....	4
Komuna dhe IOM-i nënshkruajnë marrëveshjen për ndërtimin e parkut të gjelbër të liqeni Mirusha	5
U shënuar Dita Ndërkombëtare e Demokracisë	5
Ceremoni me rastin e pensionimit të Ramë dhe Deli Thaçi.....	6
Brenda dy viteve janë riatdhesuar 140 persona	7
EVSB shenjzon vendkalimet e këmbësorëve në rrugë.....	8
U shënuar Dita e Rinisë në Malishevë	9
Malisheva përfituese e dy projekteve për renovim shkollash	9
Shqyrtohet plani për zonën me interes të veçantë Kleçkë-Divjakë	10
Kryetari Kilaj priti në takim ministrin Agani	11
Përkujtohet Dr.Shpëtim Robaj në 13 vjetorin e rënies	12
Raport nga mbledhja e kuvendit, në lidhje me vendimet e marra	13
Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e emergjencës në Malishevë	14

Filloj viti i ri shkollor 2011-2012

Malishevë, 1 shtator

Në të gjitha shkollat e komunës së Malishevës, ka filluar procesi edukativo-arsimor për vitin e ri shkollor 2011-2012. Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, z.Isuf Morina, i kanë uruar nxënësit dhe mësimdhënësit e komunës së Malishevës, me rastin e fillimit të vitit shkollor.

Komuna e Malishevës, ka rreth 17 mijë e 500 nxënës dhe 45 objekte shkollore, ku përfshihen 36 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 5 paralele të ndara fizike dhe 3 shkolla të nivelit të shkollimit të mesëm të lartë.

“Të gjitha shkollat janë të gatshme për mbarëvajtjen e rregull të procesit mësimor, si dhe është plotësuar edhe kuadri mësimor”, ka thënë, drejtori i DKA-së, Isuf Morina.

Morina, po ashtu ka konfirmuar se vetëm një pjesë e shkollës në fshatin Gurbardh, është ende duke u riparuar, dhe për disa klase mësimi do të filloj në objektin e vjetër, për dy javë.

Po ashtu sot, do të bëhet përrurimi i Sallës së Sporteve të SHMU “Imer Krasniqi” në Carrallukë, donacion i kontingjentit gjerman të KFOR-it, dhe qeverisë komunale të Malishevës.

U përruruar salla e sporteve në Carrallukë

Malishevë, 1 shtator

Sot në fshatin Carrallukë, me rastin e fillimit të vitit shkollor, është bërë edhe përrurimi i sallës së sporteve. Shiritin e përrurimit e prenë, kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, komandanti i kontingjentit gjerman të KFOR-it, dr.Christoph Rubbert, drejtori i DKA-së, z.Isuf Morina dhe drejtoresha e shkollës



“Imer Krasniqi”, znj.Fatime Krasniqi.

“Kjo sallë simbolizon më së miri, kontributin që ka dhënë KFOR-i gjerman. Sot në këtë ditë kur fillon edhe viti shkollor, kjo është dhurata



më e bukur që ka mundur t'ju bëhet këtyre nxënësve. Për neve si komunë është një obligim më pak, në kuadër të obligimeve të shumta që kemi ndaj shkollave, ndaj nxënësve dhe mësuesve të kësaj shkolle, qytetarëve dhe ndaj emrit të dëshmorit që mban kjo shkollë, Imer Krasniqi”, ka thënë kryetari Kilaj, pas përfundimit të sallës.

Ndërsa komandanti gjerman dr.Rubbert tha: “Është kënaqësi shumë e madhe për mua, që sot kemi mundur ta dorëzojmë Sallën e Sporteve, edhe është shumë mirë që këtë sallë do të kenë mundësi ta përdorin të gjithë, tash edhe dimrit mund ta përdorin për sport. Për mua është një simbol dhe një bashkëpunim më i thellë me Kosovën dhe me banorët e këtij fshati”.

Kryetari Kilaj, ka konfirmuar se “komuna ka dhënë 60 mijë euro për çmontimin, krijimin bazës dhe montimin e saj, ndërsa vlera total e sallës është rreth 300 mijë euro”. Kjo sallë plotëson standardet kohës dhe jo vetëm për nxënësit, por do të jetë në shërbim edhe për të tjerët.

Në fund, drejtorja e SHMU “Imer Krasniqi”, Fatime Krasniqi, ka falënderuar KFOR-in dhe kryetarin e komunës për këtë investim, duke e konsideruar si dhuratën më të mirë që ka mundur tu jepet nxënësve në fillimin e vitit shkollor.

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve

Për dy muaj 231 intervenime në shuarjen e zjarrit

Malishevë, 5 shtator

Gjatë dy muajve të fundit (korrik-gusht), ka pasur 231 intervenime në zjarre, ka bërë të ditur sot në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj.



Sipas z. Zogaj “situata ka qenë dhe është nën kontroll”, dhe njëkohësisht ka shprehur një falënderim për Shërbimin e Shpëtimit dhe Zjarrfikësve, të cilët sipas tij kanë vepruar në kushte shumë të vështira.

Edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim, z. Isuf Morina, ka bërë të ditur se është i gatshëm për raportim, para kuvendit, për mbarimin e vitit shkollor dhe fillimin e këtij viti.

Komuna dhe IOM-i nënshkruajnë marrëveshjen për ndërtimin e parkut të gjelbër të liqeni Mirusha

Malishevë, 7 shtator

Në mes komunës dhe IOM-it, është nënshkruara marrëveshja për ndërtimin e parkut të gjelbër në vendin e quajtur Fusha e Begut, afër liqenit artificial në Mirushë, të komunës së Malishevës.

Për këtë projekt, bashkëfinancuese do të jenë BE dhe komuna, ndërsa implementuese e projektit është IOM-i.

“Shuma e bashkëfinancimit është 99.500 euro, ndërkohë që në këtë shumë, komuna është pjesëmarrëse me 9.950 euro”, thuhet në marrëveshjen e nënshkruar sot, nga kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj.

U shënua Dita Ndërkombëtare e Demokracisë

Malishevë, 15 shtator

Me një seancë speciale të Kuvendit të Komunës së Malishevës, e organizuar së bashku me OSBE-në, është shënuar Dita Ndërkombëtare e Demokracisë, ku fjalën kryesore e mbajti Kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj, ndërsa fjalime rasti kanë mbajtur edhe përfaqësues të partive politike, pastaj përfaqësues të shoqërisë civile dhe nxënës të shkollave të mesme.

Kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, e ka vlerësuar të mirë zhvillimin e demokracisë në vend dhe në veçanti në Malishevë, duke pasur parasysh kohën e shkurtër të fillimit të zhvillimit demokracisë, dhe Kosovës si shtet shumë i ri. “Edhe në Malishevë ka të arritura në këtë drejtim dhe gjërat po ecin mbarë”, ka thënë kryetari Kilaj. “Me fillimin e organizimit të partive politike pas luftës, ka pasur divergjenca dhe dallime të mëdha mes partive, por kjo sot është tejkaluar dhe e konsideroj si një të arritur e madhe”, tha Kilaj.

Fjalime në formë të ligjëratave, për demokracinë, mbajtën edhe nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Malishevës.



Ceremoni me rastin e pensionimit të Ramë dhe Deli Thaçi

Malishevë, 16 shtator

Drejtoria Komunale e Arsimit, sot ka organizuar një ceremoni zyrtare, me rastin e daljes në pension, të dy nga punonjësve të arsimit në Malishevë, Ramë Thaçit dhe Deli Thaçit, ndërsa janë nderuar me mirënjohje nga Drejtoria e Arsimit, për kontributin e dhënë në sektorin e arsimit në komunën e

Malishevës. Me këtë rast edhe kryetari i Malishevës, iu ka ndarë nga një dhuratë, në shenjë respekti dhe falënderimi.

“Kjo është një ngjarje e veçantë, të cilën e përjetoj në shpirt”, ka thënë kryetari Kilaj, një fjalën e tij, përderisa ju ka thënë se “ Ne





ju jemi mirënjohës gjithë jetën”. “Dy profesor që i kanë dhënë shumë arsimit shqip, dy njerëz që janë shembull të punës dhe profesionit, me qëndrime të denja dhe atdhedashurie e që sot po pensionohen, besoj se të dytë do të vazhdojnë të japin kontributin e tyre edhe më tutje”, tha në fund kryetari Kilaj, duke i falënderuar për kontributin e tyre dhe njëherit ju uroj jetë të gjatë dhe suksese të mëtutjeshme në jetë.

Edhe drejtori arsimit, z.Isuf Morina, ka vlerësuar lartë kontributin e profesorëve Ramë Thaçi dhe Deli Thaçi, si “njerëz të besimit, si dy misionarë të mundit dhe të sakrificës”. “Nëse njeriu njëherë përjeton diçka të veçantë në jetën e tij, atëherë sot po e përjetojmë këtë të veçantë, daljen në pension të dy misionarëve të arsimit në Malishevë”, ka drejtori Morina.

Në fund, Ramë Thaçi, profesor ri Historisë dhe Deli Thaçi, profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, kanë falënderuar kryetarin e komunës dhe komunën e Malishevës, për organizimin e përcjelljes në pension të tyre, si dhe i kanë falënderuar të gjithë kolegët e tyre për bashkëpunimin e deritanishëm, dhe arritjen e tejkalimit të situatave të vështira, në të cilat ka kaluar arsimi në Malishevë.

Brenda dy viteve janë riatdhesuar 140 persona

Malishevë, 19 shtator

Bazuar në të dhënat e departamentit për kthim në Ministrinë Punëve të Brendshme, si dhe nga Zyrat komunale për Kthim dhe riintegrimin e të kthyerve , në komunën e Malishevës, nga viti 2010, e deri më tani janë regjistruar 140 persona, ndërsa, komuna, së bashku me ministritë përkatëse, po punon intensivisht për riintegrimin e këtyre personave.

Ardita Krasniqi, zyrtare komunale për kthim dhe riintegrim, ka bërë të ditur, se gjatë vitit 2010, nga ana e zyrës për regjistrimin e personave të riatdhesuar, kanë pranuar listën prej 81 personave të riatdhesuar, ndërsa gjatë këtij viti, janë evidentuar 38 persona.

“Në zyrën komunale për kthim janë paraqitur edhe 21 persona të tjerë, që do të thotë se deri tani, ky numër arrin në 140 persona”, ka sqaruar zyrtarja për kthimin, Ardita Krasniqi. Ajo po ashtu bën të ditur, se “komuna, përveç evidentimit dhe vizitave të drejtpërdrejta, këtyre personave ju ofrohen edhe këshillat e nevojshme, pastaj shërbimet mjekësore, si dhe ata të moshës së re, integrohen në procesin mësimor”.

“Zyra për riintegrim dhe kthim, ka bërë vizita nëpër shtëpitë e personave të riadhesuar, si dhe ka bërë kërkesa për banim për disa nga këta persona, pastaj për ushqim dhe në vazhdimësi të gjithë të kthyerve iu ofrohet ndihmë e nevojshme, brenda mundësive dhe kompetencave të komunës”, përfundon zyrtarja Krasniqi.

EVSB shenjëzon vendkalimet e këmbësorëve në rrugë

Malishevë, 23 shtator

Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB), në Malishevë, në kuadër të krijimit të ambientit të sigurt për komunitetin, kanë ndërmarrë një aksion për shënimin e vijave të vendkalimeve kryesore në Malishevë dhe disa vendbanime, me qëllim të rritjes së sigurisë në trafik.

Vendkalimet janë shënuar në rrugën “Rilindja Kombëtare” në Malishevë, në afërsi të dy shkollave, pastaj afër shkollës në Astrazup, Mirushë dhe Kijevë, aty ku frekuentimi i qytetarëve dhe në veçanti i nxënësve, është më i madh, ndërsa kanë munguar ose janë shlyer këto vendkalime.

Gjatë kryerjes së këtij aktiviteti janë përcjellë, ekipet janë përcjellë nga

Policia e Kosovës, e cila ka bërë sigurimin e ambientit në rrugë, përderisa është shënim i vijave, ndërsa



në këtë aktivitet, përveç anëtarëve të EVSB-së, kanë marrë pjesë edhe nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore, ndërsa qytetarët e kanë përshëndetur këtë aktivitet, i cili lidhet me sigurinë e tyre në trafik.

Qëllimi i këtij aktiviteti i EVSB-së, është rritja e sigurisë në trafik dhe krijimi i ambientit të sigurt për komunitetin, për çka edhe janë krijuar këto ekiye, rreth të cilave janë të bashkuar vullnetarët, të cilët paraprakisht edhe janë trajnuar dhe certifikuar nga Departamenti i Drejtësisë së SHBA-e, ICITAP.

U shënua Dita e Rinisë në Malishevë

Malishevë, 28 shtator

Sot në Malishevë, u shënua Dita e Rinisë, me aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe argëtuese, e organizuar nga Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me organizatat tjera joqeveritare rinore, që veprojnë në Malishevë.



Dita e Rinisë, ka filluar me Karvanin e Shkrimtarëve të komunës së Malishevës, për të vazhduar me një ekspozitë në pikturë, pastaj me një debat. Të tri këto aktivitete janë mbajtur në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ndërsa aktivitetet kanë vazhduar me lojëra sportive në mesin e të cilave dhe loja “thesari i fshehur”. Kjo ditë përmbyllet me një mbrëmje rinore, që organizohet në qendër të qytetit.

Aktivitetet për shënimin e Ditës së Rinisë, janë financuar nga Komuna e Malishevë, ndërkohë është mbështetur edhe nga ekipi komunal i OSBE-së në Malishevë.

Malisheva përfituese e dy projekteve për renovim shkollash

Malishevë, 29 shtator



Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka marrë një shkresë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes së cilës, është konfirmuar realizimi i dy projekteve në lidhje me renovimin e dy shkollave në komunën që ai drejton.

Në njoftim thuhet se pas vlerësimit të projekt-propozimeve, me ç'rast komuna e ka aplikuar, kanë përfituar dy shkolla fillore ajo "Dëshmorët e Kombit", në Guncat dhe "Emin Duraku", në Dragobil, në të cilat do të ketë renovime, në aspekte të ndryshme, që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve shkollore.

Projektet financohen nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European (ZNKE) dhe mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Shqyrtohet plani për zonën me interes të veçantë Kleçkë-Divjakë

Malishevë, 29 shtator

Organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH), në bashkëpunim me drejtorinë komunale të Urbanizimit, sot është bërë shqyrtimi publik i planit për zonën me interes të veçantë Kleçkë-Divjakë, e që përfshin edhe një pjesë të territorit të komunës së Malishevës.



Për kryetarin e Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, “vendimi e Qeverisë së Kosovës, për shpalljen zonë të veçantë, për simbolikën e krenarisë së luftës, të bën të ndihesh mirë edhe shpirtërisht”. “Ne qytetarët e Malishevës e dimë rëndësinë e kësaj zone, nga vendosja e njësisë së UÇK-së, ‘Çeliku’, pastaj Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Radio ‘Kosova e Lirë’, agjencia e lajmeve ‘Kosovapress’, e deri tek vendosja e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, dhe përmes këtij vendimi, kjo zonë e merr atë që i takon, si pjesë e rëndësishme e historisë”, tha kryetari midis tjerash kryetari Kilaj. Po ashtu për z. Kilaj, “kjo është e rëndësishme si për zhvillimin e turizmit në këtë pjesë, ashtu edhe për mbrojtjen e ambientit”.

Edhe zëvendësministri i MMPH-së, z. Shpend Rudi, i quajti Malet e Berishës, si “një rajon në të cilin janë mbajtur takimet të rëndësishme me faktorin ndërkombëtar, gjatë periudhës së luftës së lavdishme të UÇK-së”, e që paraprakisht, i përmendi institucionet e rëndësishme që kanë vepruar në këtë pjesë, gjatë asaj kohe.

Ndërsa, zyrtarët e Institutit për Planifikim Hapësinorë, kanë prezantuar projekt planin për zonën me interes të veçantë, projekt i cili pasi përfundon shqyrtimin publik, dhe merr formën përfundimtare., do ti dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim.

Luan Nushi dhe Shpend Agaj, kanë prezantuar projektin, i cili kap një hapësirë prej 3922 hektarësh, vlerat kulturore-historike të zonës, vlerat natyrore dhe zhvillimin socio-ekonomik të zonës. Më pas të dy zyrtarët Nushi e Agaj, janë përgjigjur në pyetjet e publikut si dhe kanë marrë vërejtje e sugjerimet, për të cilat kanë thënë se “do ti shqyrtojnë me kujdes”. Gjithashtu njoftuan se ky projekt, është i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të kësaj ministrie.

Kryetari Kilaj priti në takim ministrin Agani



Malishevë.30 shtator

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim ministrin e shëndetësisë z. Ferid Agani.

Me këtë rast z. Kilaj e ka falënderuar ministrin për këtë vizitë, dhe e njoftoj atë për situatën e përgjithshëm të mjekësisë në komunën e Malishevës, si dhe paraqiti si problem çështjen e maternitetit në kuadër të QKMF-së, e cila tash e disa vjet është pa një status të definuar nga ana e Ministrisë.

“Në maternitet, ekzistojnë të gjitha kushtet optimale, ekziston edhe stafi i kësaj lëmie, por problem na paraqitet çështje e financimit, e cila nuk është e zgjidhur nga ana e nivelit qendror, dhe kjo gjë e rëndon buxhetin e komunës”.

Lidhur me këtë ministri Agani premtoj se “që nga korriku i vitit të ardhshëm mundësitë do të jenë ndryshe dhe do të jetë një realitet tjetër edhe këtu të ju”, tha midisi tjerash ministri, duke e arsyetuar këtë me buxhetin që do të planifikohet për vitin e ardhshëm nga ana e ministrisë.

Kryetari poashtu njoftoj se komuna për çdo vit në buxhetin e saj planifikon dhe ndan një shumë mjesh për barëra për raste sociale, për të ndihmuar kategoritë e rënda në këtë komunë.

Përkujtohet Dr.Shpëtim Robaj në 13 vjetorin e rënies

Malishevë, 30 shtator

Me rastin e trembëdhjetë vjetorit të rënies, është përkujtuar Dr.Shpëtim Robaj. Në këtë përkujtim të organizuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, emrin e të cilit e mban kjo qendër, kanë marrë edhe kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, Ministri i Shëndetësisë, z.Ferid Agani, zv/ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Fatmir Shurdhaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Sali Morina, pastaj familjarë, bashkëpunëtor dhe qytetar të shumtë.



“13 vite pas rënies së tij, figura e dr. Shpëtim Robajt jo vetëm që nuk është harruar por ajo po vazhdon të rritet

pasi ai dje ishte shembull i flijimit kurse sot po bëhet shembull i angazhimit dhe i sakrificës për mjekët e rinj të cilët frymëzim e kanë angazhimin e tij në kryerjen e detyrës”, tha në fjalën e rastit, kryetari i Malishevës, Isni Kilaj.

“Doajeni i anesteziologjisë kosovare, ishte dr. Shpëtim Robaj. Personalitet i vlerave më të larta profesionale dhe njerëzore, shkencore dhe patriotike, vlera të cilat, ne synojmë ti vëmë në themelet e shtetit tonë”, tha ministri Agani, duke shprehur respektin për dr.Shpëtim Robaj.

Evokime për jetën dhe veprën e dr.Shpëtim Robajt, ka sjellë para të pranishmëve, bashkëpunëtori i tij, dr.Cen Bytyçi, ndërsa për veprimtarin e tij, ka folur drejtori i QKMF-së në Malishevë, dr.Besim Zogaj. Në fund janë bërë homazhe para bustit të dr.Shpëtim Robaj, në oborrin e QKMF-së në Malishevë.

Raport nga mbledhja e kuvendit, në lidhje me vendimet e marra

Malishevë, 30 shtator



Kuvendi i Komunës së Malishevës mbajti mbledhjen e nëntëmbëdhjetë të radhës, ku u miratua Projekt rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2012, ndërsa është debatuar edhe për përfundimin e vitit shkollor 2010-2011.

Projekt rregulloren për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës e ka prezantuar drejtori për Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, ndërsa anëtarët, e kanë miratuar këtë projekt rregullore, me vërejtjet të cilat i kanë dhënë gjatë shqyrtimit të saj.



Po ashtu në mbledhjen e sotme, është dëgjuar edhe raporti i drejtorit të Drejtorisë komunale për Arsim, Isuf Morina, në lidhje me përfundimin e vitit shkollor 2010-2011.

Në fillim të mbledhjes, është bërë edhe betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës, Ahmet Rrahmanaj, i cili zëvendëson anëtarin Naim Morina, pasi ky i fundit, do të ushtroj detyrën e drejtorit të shkollës “Bajram Curri” në Drenoc.

Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e emergjencës në Malishevë

Malishevë, 30 shtator

Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe kompania “BEN-AF”, kanë nënshkruar sot një marrëveshje për ndërtimin e emergjencës në Malishevë, e cila pritet të përfundoj, më së largu deri në dhjetor të vitit 2012.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, ndërtimi i kësaj qendre, do të kushtoj 800 mijë euro, pasi vlera e projektit për ndërtimin e saj është nxjerrë nga projekti i përgatitur dhe i aprovuar nga palët nënshkruese.

Ndërtimi i emergjencës në Malishevë, ka dalë si një nevojë e kohës, për shërbime më efektive shëndetësore, në veçanti të rasteve emergjente, për shkak të largësisë së komuna e Malishevës, ka me qendrat e mëdha spitalore.

Bazuar në lidhjet e komunikacionit rrugor, Malisheva, është qendra komunale, që i ka më së largu qendrat emergjente, dhe spitalore si, në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, apo qendrat tjera, andaj, ndërtimi i kësaj emergjence, është i domosdoshëm.